



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rregullore për zhvillimin dhe Rishikimin e Kurrikulave e Kolegjit BIZNESI” është hartuar në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor, bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 “Për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës”, Statutin e Kolegjit neni 81, në gjithë legjislacionin tjetër në fuqi dhe është miratuar me Vendim të Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor i datës 25/09/2020, miraton:

RREGULLORE PËR ZHVILLIMIN DHE RISHIKIMIN E KURRIKULAVE

Neni 1

Fushëveprimi i Rregullores për Zhvillimin dhe Rishikimin e kurrikulave obligohet të merret me zhvillimin permanent dhe rishikim të vazhdueshëm të kurrikulave .

Neni 2

Zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulave bëhet për departamentet e funksionimit në Kolegjin Biznesi. Secili departament, fakultet ka për obligim të ofroj të dhëna dhe metodologji të reja bashkëkohore të zhvillimeve të kurrikulave po sikur edhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre.

Neni 3

Kurrikulat duhet të jenë në përputhje të plotë me zhvillimet aktuale bashkëkohore në fushën shkencore për Kolegjin Biznesi për fushat e caktuara Ekonomik, Emergjencë dhe Juridik.

Neni 4

Secili Departament/Fakultet , mbanë së paku dy mbledhje gjatë vitit akademik dhe sipas nevojës.

Neni 5

5.1 Komisioni për zhvillimin dhe Rishikimin e Kurrikulave themelohet nga KLMSH

5.2. Për Zhvillimin dhe Rishikimin e Kurrikulave themelohet Komisioni i veçantë

5.3. Anëtarët e Komisionit mbajë gradën profesor si dhe duhet të reflektojnë fushat e zhvillimit të studimeve dhe nivelin e studimeve .

Neni 6

Përbërja e Komisionit

- 6.1.Komisioni përbëhet nga gjashtë profesor me gradën e fundit shkencore dhe dy student, një student duhet të përfaqësoj studimet themelore dhe njëri do të përfaqësoj studentet posdiplomik.
- 6.2.Komisioni mbikëqyr punën e zbatimit të kurrikulave të mësimi
- 6.3.Komisioni propozon dhe rekomandon ndryshimet në kurrikulave
- 6.3.Komisioni ofron informacione drejt zhvillimeve të reja në fushat e studimeve përkatëse
- 6.4.Komisioni mund të obligoj ndryshimin e kurrikulave të caktuara

Neni 7

- 7.1Komisioni do të rishikoj kurrikulat mësimore për çdo vit akademik
- 7.2.Komisioni do të propozoj edhe trajnime adekuate për stafin e ri në hartimin e kurrikulave
- 7.3. Komisioni jep opinione me shkrim rreth kurrikulave të caktuar për programet e caktuara.

Neni 8

Komisioni ofron këshilla shkencore dhe metodologji për përmbajtjen e kurrikulave .

Neni 9

Komisioni mban takime për departamentet e caktuara sipas nevojave të departamenteve.

Neni 10

Komisioni mbledhet para fillimit të vitit akademik.

Neni 11

Komisioni po ashtu ofron të dhëna shtesë, detaje dhe praktika të mira në zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kurrikulave të mësimi.

Kryetari i KLMSH i Kolegjit BIZNESI

/Prof dr Shyqeri Kabashi-Dekan/